



Dhurimet e Kosovës për OSHC-të 2022

Shpeshtësia e mbështetjes për OSHC-të ishte në nivelin më të lartë në vitin 2022 që kur Catalyst Balkans filloi ta gjurmonte filantropinë në Kosovë. Më shumë se 2.3 milionë euro janë dhuruar përmes 493 rasteve të donacioneve. Krahasuar me vitin e kaluar, është shënuar një rritje prej 67% e numrit të rasteve të donacioneve për OSHC-të.



2,311,000 EUR

shuma e regjistruar e dhuruar




493

numri i rasteve


Dhurimet për OSHC-të në Kosovë – 2018 – 2022

■ Shuma e regjistruar (në miliona EUR) ■ Nr. i rasteve të dhurimit




Kauzat

Zbutja e varfërisë mbeti kauza kryesore e dhurimeve për OSHC-të në Kosovë. Dhurimi sezonal ishte kauza e dytë që u mbështet, me një rritje të rasteve krahasuar me vitin e kaluar. Nga ana tjetër, mbështetja për grupet e marginalizuara pësoi një rënie prej 10% krahasuar me vitin 2021.




Donatorët

Përderisa në vitin 2021 shumica e donacioneve për OSHC-të erdhën nga individë, në vitin 2022 qytetarët përmes dhurimit masiv individual ishin donatorët më të shpeshtë. Përqindja e rasteve nga donatorët individualë pësoi rënie, si dhe shumat e dhuruara nga sektori i korporatave.



Përfituesit Përfundimtarë


Ashtu si në vitet e mëparshme, personat në nevojë ekonomike ishin grupet përfituese më të mbështetura përmes punës së OSHC-ve, 20% më shumë se në vitin 2021. Si personat me probleme shëndetësore, ashtu edhe personat me aftësi të kufizuara pësuan rënie të vogël në shpëstësinë e mbështetjes.



Efektet e Synuara të Dhurimit

Donations with short-term intended effects, such as food, clothes, humanitarian support, and other necessities had the largest share of donation instances and value of donations.

Donations with long-term effects - equipment, scholarships, services, and capital investments had a share of 7.9% of all donation instances.



Burimi: kosovadhuron.org



Kjo infografikë është bërë e mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Catalyst Balkans dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesë vjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).